

INVESTIM 10 MILIONË EURO NË POGRADEC

OSHEE është duke investuar 10 milionë euro në bashkinë e Pogradecit çka do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e furnizimit me energji elektrike për 48 mijë abonentë. Investimi përfshin ndërtimin e nënstacionit të ri, vendosjen e 10 fiderave, ndërtimin e 65 kabinave, shtrimin e 42 km linjë tensioni të mesëm 20 kv, 40 kilometra linjë kablore me standard të sigurt ABC si dhe vendosjen e 800 shtyllave.

UJËSJELLËS I RI NË ERSEKË

Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit në qytetin e Ersekës është drejt përfundimit dhe vënia e tij në funksion do të sigurojë furnizim të pandërprerë e me cilësi për të gjithë banorët. Me rrjetin e ri bëhet e mundur eliminimi i humbjeve dhe ndotjeve, shmangen lidhjet e paligjshme, ndërsa projekti parashikon gjithashtu lidhjen e kontratave të reja dhe pajisjen me matësa të të gjithë abonentëve.

KORÇË, OSHEE ME ZYRA TË REJA RAJONALE

Zyrat Rajonale të OSHEE në qytetin e Korçës tashmë kanë një pamje dinjitoze duke krijuar kushte dhe standarde më të mira si për punonjësit, ashtu edhe për qytetarët të cilët paraqiten pranë këtyre zyrave për të marrë shërbimet. Në saj të një investimi me vlerë prej 60 milionë lekësh u bë e mundur rikonstrukcioni i godinës duke përfshirë zyrat si dhe pajisjen e tyre me logjistikë krejtësisht të re.

DITË PUNE NË QARKUN KORÇË

Qarku i Korçës ishte ndalesa e radhës e ministres, Belinda Balluku, në kuadër të programit të ditës së punës në qark. Balluku inspektoi zyrat e DRSHTRR si dhe spitalin rajonal të Korçës ku u njoh me ecurinë e punës por edhe problematikat me të cilat ndeshet personeli që shërben aty. Në vizitën e saj në qarkun e Korçës, Balluku vizitoi një biznes fason në të cilin janë punësuar 130 punonjës ndërsa angazhimi i kompanisë është për ta rritur edhe më tej këtë numër.

DPSHTRR, SHTOHET NUMRI I SHËRBIMEVE

Tashmë leje drejtimi ndërkombëtare dhe leje qarkullimi ndërkombëtare mund të tërhiqen edhe tek zyrat e DRSHTRR Tiranë, pranë Qendrës së Kolaudimit të Mjeteve, përveçse në DRSHTRR Tiranë në Kashar. Ofrimi i këtij shërbimi bën të mundur shmangen e radhëve si dhe kursimin e kohës për qytetarët. Leje drejtimi ndërkombëtare dhe leja e qarkullimit ndërkombëtare janë të vlefshme për 3 vite.

HEC-KOMAN, PËRDORIMI I TEKNOLOGJIVE TË FUNDIT

Në Hec-Koman inxhinierët monitorojnë pusët e inklinometrave duke përdorur pajisje të teknologjisë së fundit. Implementimi i teknologjisë së re me pajisjen SisGeo, për matjen e qëndrueshmërisë dhe monitorimin e lëvizjeve shkëmbore, rrit sigurinë e digës dhe lehtëson punën për inxhinierët në HEC-KOMAN.